



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 11.7.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi, Etem Arifi, Salih Morina dhe Liburn Aliu, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.6.2011 dhe 4.7.2011;**
3. **Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me disa shtesa për pikën të ndryshme (për Drinin e Bardhë dhe Rekomandimin për leximin e dytë të Regjistrit të Pronave si dhe leximin e parë të Rregullimit të Tokave).

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.6.2011 nr.12 dhe 4.7.2011 nr.13

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur 23.6.2011 dhe 4.7.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër

Kryetari Nait Hasani konstatoi se grupi punues dhe ai bashkërisht kanë arritur të përmbyllin shqyrtimin e projektligjit për Kadastër me miratimin e 22 amendamenteve të cilat sipas **Liburn Aliut** përfaqësojnë qëndrimin e grupit punues dhe komisionit përkundër faktit se ka pas të meta ky projektligj. Ky grup punues, sipas tij, është munduar ta bëjë më të mirën. Ai tha se Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” do të dalë në leximin e dytë me qëndrimin e tij politik ngase ky projektligj përmban një Agjenci Kadastrale që rrallë ndonjë shtet e ka (përveç Kosovës dhe Bosnjës) si pasojë i Pakos së Ahtisarit.

Komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Miratohet Raporti me Amendamente i raportuesit-Kryesuesit të grupit punues Liburn Aliu.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për Kadastër me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, si vijon :

Amendamenti 1

Të riformulohet neni 1 si në vijim:

Ky ligj rregullon kadastrin e palujtshmërive, matjet shtetërore dhe kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale si dhe përfitimin, regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale.

Amendamenti 2

Të riformulohet nënparagrafi 1.2 i paragrafit 1 të nenit 3 si në vijim:

1.2. Parcela kadastrale - sipërfaqen e përkufizuar të tokës e identifikuar me numër të parcelës dhe e regjistruar në hartën kadastrale me sipërfaqe reale në projektionin hartografik dhe sipërfaqe të regjistruar në RDPP.

Në tërë tekstin e Projektligjit termi “**Parcela Toksore**” zëvendësohet me “**Parcela kadastrale**”.

Amendamenti 3

Në nënparagrafin 1.7 të paragrafit 1 të **Nenit 3** fjalia “**Vijat kufitare përfundimtare**” të zëvendësohet me fjalinë “**Kufiri përfundimtar i parcelës**”.

Amendamenti 4

Në nënparagrafin 1.16 të paragrafit 1 të **Nenit 3** të fshihet shkurtesa “**NSDI**”.

Amendamenti 5

Pas nënparagrafit 23 të paragrafit 1 të nenit 3 të shtohet katër nënparagraf të ri si në vijim:

1.24 Sipërfaqja e parcelës kadastrale - sipërfaqen reale të parcelës kadastrale të llogaritur përmes koordinatave të kufirit të parcelës në projektionin hartografik.

1.25 Sipërfaqja e parcelës e regjistruar në RDPP - sipërfaqe e llogaritur nga planet analoge dhe e regjistruar në RDPP.

1.26 AKK – Agjencia Kadastrale e Kosovës.

1.27 ZKK – Zyra Komunale Kadastrale.

Amendamenti 6

Në gjithë përmbajtjen e Projektligjit aty ku përdoret termi “**Agjencia**”, “**Agjencia Kadastrale**” dhe “**Agjencia Kadastrale e Kosovës**” të zëvendësohet me shkurtesën “**AKK**”, ndërsa në rast të emërimit të neneve të përdoret “**Agjencia Kadastrale e Kosovës**”.

Amendamenti 7

Në gjithë përmbajtjen e Projektligjit aty ku përdoret termi “**Zyra Komunale Kadastrale**” dhe “**Zyra Kadastrale Komunale**” të zëvendësohen me shkurtesën “**ZKK**”, ndërsa në rast të emërimit të neneve të përdoret “**Zyra Komunale Kadastrale**”

Amendamenti 8

Të riformulohet paragrafi 9 i nenit 4 si në vijim:

9. Agjencia është përgjegjëse për licencimin e kompanive dhe gjeodetëve për kryerjen e matjeve kadastrale. Licenca mund të jepet për të gjitha matjet kadastrale apo për ato specifike.

Amendamenti 9

Të riformulohet nënparagrafi 11.3 dhe 11.4 i paragrafit 11 të nenit 4 si në vijim:

11.3 anulohet licencën për një kompani gjeodete apo gjeodet te licencuar,

11.4 anulohet certifikimin për aktivitete kadastrale të Zyrës Komunale Kadastrale.

Amendamenti 10

Pas paragrafit 11 të nenit 4 shtohet një paragraf i ri, ndërsa paragrafët aktual me numër 12 dhe 13 të rinumërohet me numër 13 dhe 14:

12. Aktivitetet kadastrale të ZKK-së pas anulimit të certifikimit sipas paragrafit 11 të këtij neni, është përgjegjëse ti kryej AKK.

Amendamenti 11

Të riformulohet neni 5 si në vijim:

Neni 5

Zyra Komunale Kadastrale

1. ZKK është organ komunal dhe është përgjegjëse për funksionimin e kadastrit.
2. ZKK kryen matje kadastrale.
3. ZKK kryen të gjitha aktivitetet kadastrale në përputhje me kompetencat e deleguara nga niveli qendror, dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimet administrative të nxjerra nga AKK dhe Ministria.
4. Nëpunësi i ZKK që kryen matje kadastrale duhet të jenë i certifikuar nga AKK.
5. Të gjitha aktivitetet e ZKK realizohen dhe pasqyrohen në bazën qendrore të të dhënave të AKK-së.

Amendamenti 12

Të riformulohet paragrafi 5 dhe 6 i nenit 7 si në vijim:

5. Komuna është e ndarë në Zona Kadastrale. AKK-ja vendosë të ndryshojë ndarjen në zona kadastrale pas konsultimit me komunën dhe në përputhje me rregullat e parapara me akt nënligjor të nxjerr nga AKK-ja.

6. Me ndryshimin e kufirit në mes dy komunave ndryshohet edhe kufiri i zonave kadastrale. Njësia kadastrale i takon një zonë të caktuar kadastrale.

Amendamenti 13

Të riformulohet paragrafi 8 i nenit 18 si në vijim:

8. Kur pronarët e pranojnë kufirin e parcelës siç është paraqitur në terren, kufiri do të paraqitet në shënime dhe do të nënshkruhet nga pronarët. Pozita e pranuar e kufirit të parcelës do të konsiderohet si kufi përfundimtar i parcelës.

Amendamenti 14

Të riformulohet paragrafi 10 i nenit 18 si në vijim:

10. Në procedurën e caktimit të kufirit, pronari mund të përfaqësohet me autorizim të veçantë nga personi i trete.

Amendamenti 15

Të riformulohet paragrafi 13 i nenit 18 si në vijim:

13. Pas pranimit të kërkesës për regjistrimin e kufirit të caktuar, bazuar në shënimet e autoritetit përgjegjës, ZKK-ja do të verifikojë së pari se përcaktimi i kufirit është kryer në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Amendamenti 16

Të riformulohet nënparagrafi 15.1 i paragrafit 15 të nenit 18 si në vijim:

15.1. kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 12 të këtij neni.

Amendamenti 17

Të riformulohet neni 21 si në vijim:

Neni 21

Matjet shtetërore

1. Matjet shtetërore përfshijnë sistemin e të dhënave gjeodezike të nevojshme për paraqitjen tredimensionale të territorit të Republikës së Kosovës, krijimin e hartave dhe rrjetave gjeodezike për qëllim të kadastrit, gjeodezisë dhe për qëllime tjera.
2. Matjet shtetërore përfshijnë punët themelore gjeodezike, punët për matjet gjeodezike shtetërore dhe zhvillimin e hartave si dhe matjet dhe shënimin e kufirit shtetëror.
3. Punët gjeodezike për vendosjen e rrjetit referent shtetëror, rrjetit të nivelimit dhe aktiviteteve tjera gjeodezike si dhe përcaktimin dhe shënimin e vijës kufitare shtetërore janë kompetence e AKK-së rregullohen me akte te veçanta nënligjore.

Amendamenti 18

Në nenin 23 të fshihet fjalia *“dhe për mirëmbajtjen e sistemit të adresave në Republikën e Kosovës”*.

Amendamenti 19

Të riformulohet neni 26 si në vijim:

Institucionet qeveritare dhe lokale marrin të dhënat nga kadastri, sipas mënyrës së përcaktuar me legjislacionin në fuqi të propozuar nga AKK-ja.

Amendamenti 20

Të riformulohet paragrafi 1 i nenit 27 si në vijim:

1. Parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit nga ZKK-ja brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e refuzimit. ZKK-ja konfirmon kohën dhe datën e pranimit të kërkesës për rishqyrtim.

Amendamenti 21

Të riformulohet paragrafi 4 i nenit 28 si në vijim:

4. ZKK zbaton vendimin e AKK. Nëse ZKK nuk e bën ekzekutimin atëherë ekzekutim e vendimit e bën AKK.

Amendamenti 22

Të riformulohet neni 29 si në vijim:

Neni 29

Rindërtimi i kadastrit dhe i RDPP-ës

1. Rindërtimi i kadastrit dhe RDPP-ës lejohet kur të dhënave në një zonë kadastrale janë të pasakta dhe me mirëmbajtje të rregullt nuk mund të regjistrohen.
2. Rindërtimit përfshinë paraqitjen në hartë dhe regjistër të gjitha njësive kadastrale në zonën kadastrale dhe të drejtat pronësore për njësit kadastrale.
3. Rindërtimi nuk do të përfshijë caktimin dhe ri-rregullimin e kufirit sipas nenit 18, 19 dhe 20 të këtij ligji.
4. Vendimi për fillimin e rindërtimit të një zone kadastrale apo të një pjese të zonës kadastrale merret nga Ministri. Vendimi bazohet në Planin për rindërtim i cili përbëhet nga këto informata:
 - 4.1. zona kadastrale e cila do të rindërtohet;
 - 4.2. vlerësimi i gjendjes aktuale të regjistrit të kadastrit dhe RDPP-ës dhe problemeve që i krijohen nga gjendja e pasaktë e informacioneve kadastrale
 - 4.3. inventari i kërkesave pronësore i përpiluar nga Agjencia Kosovare e Pronave;
 - 4.4. përmbledhja e procedurave dhe metodave të punës të cilat do të zbatohen;
 - 4.5. vlerësimi i buxhetit të domosdoshëm dhe mbulesa e këtij buxheti. Buxheti do të përmbajë vlerësimin e kohës së domosdoshme të kuadrit të Agjencisë dhe të komunës për kryerjen e rindërtimit.
5. Shpenzimet për rindërtim paguhen nga qeveria, me përjashtim të rastit kur Kuvendi Komunal, për arsye të caktuara, kërkon rindërtimin. Në atë rast Komuna i mbulon shpenzimet. Fondet për rindërtim do të jenë në dispozicion përmes buxhetit të Agjencisë.
6. Ministri do ta emërojë Komisionin përgjegjës për ekzekutimin e Planit për rindërtim e kadastrit. Komisioni përbëhet prej një inxhinieri të gjeodezisë dhe një jurist në cilësi të kryesuesit të komisionit nga Agjencia Kadastrale e Kosoves, një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës, një përfaqësues nga Zyra Komunale Kadastrale dhe një përfaqësues i Zonës kadastrale

ku kryhet rindërtimi. Kur Agjencia Kosovare e Pronave i ka te regjistruara kërkesat pronësore në zonat kadastrale të cilat do të rindërtohen, në komision do të marr pjesë një përfaqësues i Agjencisë Kosovare për Prona. Aktiviteti i Komisionit do të rregullohet me një akt nënligjor të nxjerr nga Ministria.

7. Komisioni do ta organizojë fushatën e sensibilizimit për publikut, e cila rregullohet me akt të veçanta nënligjor.

8. Subjekti i autorizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës mbledhë të dhënat në terren mbi formën faktike të njësive kadastrale dhe informata mbi transferët e paregjistruara si dhe informatat për ndryshimet e tjera pronësore.

Subjekti i autorizuar dhe Komisioni do ta shfrytëzojnë inventarin e kërkesave pronësore të Agjencisë Kosovare të Pronave.

9. Bazuar në të dhënat e mbledhura sipas paragrafit 29.7 përgatitet harta kadastrale me njësitë kadastrale të rindërtuara, lista e personave të përfshirë në procesin e rindërtimit me të drejtat pronësore për pronaret e njësive kadastrale.

10. Të dhënat nga neni 29.8 me vendim të Komisionit paraqiten për shikim publik. Ftesa për të marrë pjesë në shikimin publik, do t'i dërgohet të gjithë banorëve të zonës kadastrale dhe do të publikohet së paku 2 gazeta të shtypit ditorë. Shikim publik zgjatë gjashtëdhjetë (60) ditë dhe pas kalimit të afatit komisioni miraton të dhënat e publikuara.

11. Palët mund të kontestojnë vendimin i Komisionit sipas nenit 29.9 brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

12. Pala që ka paraqitur ankesë sipas nenit 29.10 kundër pjesës së hartës apo listës së personave nga rindërtimi ftohen në seancë dëgjimore nga komisioni. Komisioni tenton të arrij marrëveshje në mes të palëve të interesuara. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore komisioni merr vendim.

13. Pas trajtimit të të gjitha ankesave, Komisioni merr vendimin se zona kadastrale është rindërtuar.

14. Palët që kanë shfrytëzuar të drejtën sipas nenit 29.10 mund të parashtrojnë ankesë në gjykatë.

15. Komisioni ndryshon hartën apo listën e personave nga rindërtimi bazuar në vendimin e gjykatës ashtu siç parashihet në paragrafin 29.13 të këtij ligji.

16. Komisioni do të përpilojë një raport zyrtar për hartën dhe listën e personave nga rindërtimi me të drejtat pronësore të regjistruara dhe do ta prezantojë këtë raport zyrtarë në Agjenci. Raporti zyrtar shqyrtohet për t'i plotësuar kërkesat nga neni 36, i Ligjit për pronësinë dhe të drejtat sendore nr. 03/L-154. Regjistrimi në RDPP shërben si titull absolut për të drejtat e njohura nga rindërtimi.

Të ndryshme

Në këtë pikë komisioni vendosi dhe debatoi si vijon :

P Ë R F U N D I M

Konfirmohet për leximin e dytë projektligji për Regjistrin e Pronave, pasi që komisionet e përhershme kanë përfunduar shqyrtimin në kuadër të kompetencave që kanë në cilësinë e komisioneve të përhershme.

Lidhur me projektligjin e dërguar nga Qeveria për Rregullimin e Tokës **Nait Hasani** arsyetoi shkurtimisht se në Kosovë kanë mbetur shumë toka të pa rregulluara me komasacion, ndaj me këtë projektligj synohet të kompletohen punët e mbetura në përmbledhjen e tokave bujqësore, komisioni nxori :

R E K O M A N D I M **për mbledhjen plenare**

Të miratohet në parim, projektligji për Rregullimin e Tokës.

Në vazhdim komisioni debatoi për vizitat e komisionit në kuadër të monitorimit të Ligjit për Tokën Bujqësore por edhe jashta saj siç është vizita në Drinin e Bardhë pasi që si tha **Liburn Aliu** meriton një trajtim të veçantë. Pasi që zyrtari i fushës këshilloi se Drini i Bardhë do të trajtohet më mirë përmes monitorimit të Ligjit për VNM, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Formohet grupi punues për monitorimin e Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me anëtarët si vijon : Liburn Aliu-kryesues, Salih Morina, Sevdije Lama dhe Nijazi Idrizi.

Vizitat e komisionit në kuadër të monitorimit të Ligjit për Tokën Bujqësore, të cilat do të mvaren nga takimet në Kuvend dhe nga mbledhjet plenare, janë :

- **Më 12.7.2011 komisioni viziton Fakultetin e Bujqësisë, ndërsa GP për Tokën Bujqësore viziton AKK-në**
- **Më 18.7.2011 komisioni përkatësisht GP viziton komunat Viti dhe Ferizaj,**
- **Më 19.7.2011 komisioni (GP) viziton komunën Gjakovë dhe Pejë,**
- **Më 20 ose 21 korrik vizitohet Prizreni dhe Drini Bardhë,**
- **Më 22 korrik vizitohet komuna Mitrovicë**

(datat mund të ndryshojnë)

Mbledhja përfundoi në orën 12,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani